



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA Nr.03-190

22.05.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (3) dhe paragrafin (6) dhe neni 29 nga Ligji për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13 dhe 13/14), Rregullorja për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën e transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/15), pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.03-1892/1 datë 24.4.2023 dhe konkluzioni ark .nr. 02-2106/3 datë 19.5.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur me 18.5.2023 miratoi si vijon:

**Aktvendim
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) televizioni IRIS SHPK Shtip, për shkeljen e kryer të nenit 15 paragrafi (3) nga Ligji për media (LM), në mënyrë që transmetuesi në afatin e parë të përcaktuar (më së voni deri më 31 mars) nuk ka publikuar në programin e tij të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe për burimet e financimit në vitin e paraprak (reklama, sponsorizime, shitje të përmbajtjeve, shërbime të ofruara palëve të treta, etj.) dhe drejtuar Agjencisë nuk ka dorëzuar regjistrimin e shpalljes në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1892/1 datë 24.4.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Televizioni SHTR IRIS SHPK Shtip, që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative për punën e botuesve të mediave në aspektin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullativ kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave nga LM.

Në bazë të nenit 15 paragrafi (3) të LM, transmetuesit janë të obliguar që të dhënat nga paragrafi (1) nënparagrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni t'i publikojnë në programin e tyre, së paku tri herë në vit, në kohën kryesore dhe regjistrimin e shpalljes ta dorëzojnë tek organi rregullativ kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në mënyrën e përcaktuar nga organi rregullativ kompetent.

Në pajtim me nenin 4, paragrafit (1) nënparagrafit 1 të Rregullores për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën (funktionimin) e transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/15), transmetuesit janë të obliguar që të publikojnë të dhënat për herën e parë jo më vonë se 31 mars.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit, më 24 prill 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative të shërbimit programor televiziv të SHTR Televizioni IRIS SHPK Shtip, dhe ka konstatuar shkelje të nenit 15 paragrafi (3) nga LM.

Me mbikëqyrje të rregullt është konstatuar se televizioni SHTR IRIS SHPK Shtip, në afatin e parë të parashikuar (më së voni deri më 31 mars) nuk ka shpallur në programin e tij të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktor / redaktorët përgjegjës dhe për burimet e financimit në vitin paraprak (reklama, sponsorizim, shitje të përmbajtjeve, shërbime ofruar personave të tjerë dhe të ngjashme) dhe drejtua Agjencisë nuk dorëzoi regjistrim nga njoftimi në afat prej 15 ditësh nga dita e njoftimit .

Shkelja nga pika 1 i këtij aktvendimi, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1892/1 datë 24.4.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1 .

Sipas neni 23 paragrafi (30) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR televizion IRIS SHPK Shtip, më 25.4.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr.03-1892/2 datë 25.4.2023, ku i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 03-1892/1 datë 24.4.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 27.4.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 18.5.2023, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR televizion IRIS SHPK Shtip t'i shqipton masë-vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të ZLSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (3) dhe paragrafi (6) dhe neni 29 të LM, Rregulloren për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën e transmetuesve, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1892 /1 datë 24.4.2023 dhe Konkluzioni nr. 02-2106/3 nga 19.5.2023, për shkak të konstatimit të mospërputhjes me dispozitat e LM, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të mbajtur më 18.5.2023, ka miratuar Aktvendim me të cilin paralajmëron publikisht Televizionin SHTR IRIS SHPK Shtip, dhe udhëzohet që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në bazë të nenit 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë padie për të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, nr . 03-1892/1 datë 24.4.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padiapër ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.